

## Barazia gjinore objektiv i shoqërisë (2Lonline.com)

E mërkurë, 09 Nëntor 2011 12:48



Kamenicë – (2LONLINE) - Intercooperation – Projekti LOGOS dhe Radio Premiera në Kamenicë kanë filluar një fushatë mediale për promovimin e ligjeve që mbështesin barazinë gjinore në Kosovë. Fushata mediale parasheh përgatitjen dhe transmetimin e 18 radio programeve në këtë sferë.

Drejtori i Programit LOGOS në Kosovë Norbert Piljs në një solemnitet të organizuar me rastin e fillimit të kësaj fushate, ka thënë se Qeveria Zvicerane i kushton vëmendje të posaçme çështjes së barazisë gjinore.

“Programi LOGOS është i financuar nga Qeveria Zvicerane dhe punon në nëntë komuna të rajonit të Gjilanit. Ne i kemi nënshkruar kontratat javën e kaluar dhe kjo sot këtu është ngjarja e parë e kësaj faze të projekteve të barazisë gjinore. Legjislacioni në këto hapësira sa i takon kësaj fushe ka qenë

i mirë, edhe në periudhën e Jugosllavisë si dhe tani me ligjet e reja të Kosovës, por mungon zbatimi i mirëfilltë në praktikë. Femrat janë gjysma e komunitetit, i kanë të drejtat e tyre por edhe ka kapacitete të mëdha në gjininë femrore, andaj duhet punuar që ky kapacitet të ngritët edhe më tepër dhe të bëhet sa më i dukshëm për shoqërinë”, ka thënë Norbert Piljs.

Fatmir Matoshi nga Radio Premiera, ka thënë se projekti medial ka tri tema kryesore, mbështetjen e grave në politikë, këshillat mjekësore përmes radio programeve dhe ngritjen e debatit rreth implementimit të drejtë të ligjit mbi trashëgiminë familjare.

Zejnije Lenjani, zyrtare e barazisë gjinore në Komunën e Kamenicës ka falënderuar LOGOS-in dhe Radion Premiera për realizimin e këtij projekti dhe ka premtuar mbështetjen dhe bashkëpunimin e zyrës së saj në implementimin e projektit.

Projekti do të fillojë së implementuari në nëntor të vitit 2011 dhe do të përfundoj në prill 2012. Kohëzgjatja e projektit do të jetë gjashtë muaj.

[http://www.2lonline.com/index.php?option=com\\_content&view=article&id=4105:barazia-gjinore-objektiv-i-shoqerise&catid=71:sociale&Itemid=400](http://www.2lonline.com/index.php?option=com_content&view=article&id=4105:barazia-gjinore-objektiv-i-shoqerise&catid=71:sociale&Itemid=400)